**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**

**DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER JULIAN ZHELEGU**
**ADRESA Njesia Bashkiake nr. 5, Rr. Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr. 2**
**TEL: 0682027818**

# KONTRATË SHITJE PASURI E PALUAJTSHME

(KONTRATË SHITJE PASURI E PALUAJTSHME ME REZERVË PA KALIM PRONËSIE)

**Nr. repertori: 10052** **Nr. koleksioni: 3314**

**Tirane më 25/11/2021**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

A2021053950294039062

A2021053950294039062

**KONTRATË SHITJE ME REZERVE**
***- Pasuri e Paluajtshme -***

Sot, më datë 25 / 11 / 2021 (dy mijë e njëzet e një), në Tiranë dhe përpara meje Julian Zhelegu, Noter i Dhomës së Noterisë Tiranë, me zyre noteriale ne adresën Rr. Pjetër Bogdani, nr. 13, K. I, u paraqiten personalisht dhe kërkuan redaktimin e këtij akti palët e mëposhtme:

**Shoqëria "FaH & Klo" shpk,** një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar e që funksionon sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar me NUIS L91408031L dhe me seli në adresën rruga "Ded Gjo Luli", me pasuri e paluajtshme Nr.6/901, zona kadastrale 8350, vol. 38, faqe 211, Tiranë, e përfaqësuar ligjërisht nga Administratori i saj **Basri Hakcani**, shtetas shqiptar, i biri i Mexhitit dhe Gjylysfijes, i ditelindjes 12.09.1985, lindur e banues në Tiranë, Rr. Gaspër Guga; Nd. 28; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1003; mbajtës i letërnjoftimit me nr. 034970860 dhe nr. personal I50912021E, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pa kufizime te kompetencave të administrimit;

*(në vijim referuar si "**Shitësi**")*

*dhe*

**Shoqëria "K.D Company" shpk,** një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar e që funksionon sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar me NUIS M12204073B dhe me seli në adresën Lagjja Sauk i Vjetër, rruga "Xhabrahimet", ndërtesa nr. 21, Tiranë, e përfaqësuar ligjërisht nga Administratori i saj i vetëm **Xhuljan Disha**, shtetas shqiptar, i biri i Defrimit dhe Natashës, i ditelindjes 1.7.1996, lindur e banues në Tiranë, me adresë Rr. Kadri Brahimaj, Nd. 20, H. 1, Njësia Administrative nr. 2, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 032704722 dhe nr. personal J60701095G, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pa kufizime te kompetencave të administrimit;

*(në vijim referuar si "**Blerësi**")*

Unë, noteri, pasi verifikova statusin ligjor të palëve dhe të përfaqësuesve te tyre, konstatova se janë madhore dhe me zotësi te plote juridike për të vepruar.

**Meqenëse:**

A. Shitësi është pronari i vetëm i ligjshëm i pasurisë se paluajtshme TRUALL me sipërfaqe prej 921 (nëntëqind e njëzet e një) metra katrorë, nga e cila NDERTESE 3 (tre) katëshe "Godine banimi 3 kate me podrum", e ndërtuar sipas lejes se ndërtimit me nr. 5, date 29.9.2011, me sipërfaqe totale 1245,8 metra katrore, dhe kati i katërt (me destinacion social-ekonomik) dhe sipërfaqe 337,3 metra katrore, i fituar sipas lejes se legalizimit, bashkëlidhur, që ndodhet në Sauk, Tirane, dhe është regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme pranë ASHK Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1 me nr. pasurie 125/159, ZK 3266, vol. 16, f. 206, kod unik pasurie 3266016206, (në vijim "**Pasuria**").
B. Unë Noteri verifikova regjistrimet ne lidhje me Pasurinë dhe rezulton nga kartela e Pasurisë, që i bashkëlidhet Kontratës, se Pasuria është ne pronësinë e vetme ligjore te kaluesit të

A2021053950294039062

pronësisë dhe e ngarkuar me barrë hipotekore sipas Kontratës së Hipotekës me nr. 6681 rep, nr. 2510 kol, datë 29.10.2020 e Noter Julian Zhelegu për shumën prej LEK 100.000.000 ne favor te Bankës CREDINS, e cila nëpërmjet Deklaratës Noteriale me nr. 9606 rep, nr. 3134 kol, datë 12.11.2021 e noter Julian Zhelegu, ka dhënë pëlqimin e saj për lidhjen dhe zbatimin e kësaj Kontrate. Palët deklarojnë se njohin e pranojnë barrën hipotekore që rendon mbi Pasurinë sipas përshkrimeve me sipër.

C. Shitësi dëshiron t`i shesë Blerësit dhe Blerësi dëshiron te blejë nga Shitësi Pasurinë dhe pasi Palët kane biseduar ne lidhje me shitjen, kane rene dakord me kushtet dhe afatet e shitjes, qe përmbahen ne këtë Kontrate.

Me vullnetin e tyre të lirë, të pacenuar e të pavesuar, bazuar në nenin 83, nenet 192 e vijues, nenet 705 e vijues, 750 e vijues te Kodit Civil, neni 63/1/k, 96, 105/2/ë, 105/3, 105/5, 126 dhe 127 të Ligjit 110/2018 "Për Noterinë", vendosën, kërkuan dhe ranë dakord te hartojnë këtë kontratë shitjeje (në vijim "**Kontrata**"), me përmbajtje si vijon:

## Neni 1
## Objekti i kontratës

1.1. Nëpërmjet kësaj Kontrate Shitësi i shet Blerësit dhe Blerësi blen nga Shitësi kundrejt çmimit të shitjes dhe sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Kontratë Pasurinë e paluajtshme TRUALL me sipërfaqe prej 921 (nëntëqind e njëzet e një) metra katrorë, nga e cila NDERTESE 3 (tre) katëshe "Godine banimi 3 kate me podrum", e ndërtuar sipas lejes se ndërtimit me nr. 5, date 29.9.2011, me sipërfaqe totale 1245,8 metra katrore, dhe kati i katërt (me destinacion social-ekonomik) dhe sipërfaqe 337,3 metra katrore, i fituar sipas lejes se legalizimit, bashkëlidhur, që ndodhet në Sauk, Tirane, dhe është regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme pranë ASHK Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1 me nr. pasurie 125/159, ZK 3266, vol. 16, f. 206, kod unik pasurie 3266016206.

## Neni 2
## Çmimi i shitjes dhe mënyra e pagesës – Tatimet dhe shpenzimet

2.1. Palët kane rene dakord që çmimi total i shitjes së Pasurisë është ALL 118.000.000 (njëqind e tetëmbëdhjetë milionë lekë) (në vijim "***Çmimi i Shitjes***"), që përfshin nuk përfshin taksat dhe tatimet e zbatueshme mbi shitjen. Palët deklarojnë se Çmimi i Shitjes është caktuar në marrëveshje ndërmjet tyre dhe gjendet prej tyre i drejtë dhe i arsyeshëm në përputhje me kushtet e tregut. Çmimi i shitjes perbehet nga çmimi i shitjes së truallit në vlerën prej LEK 3.023.643 (tre milione e njezet e tre mije e gjashtëqind e dyzet e tre lekë) dhe çmimi i shitjes së ndërtesës në vlerën prej LEK 114.976.357 (njëqind e katërmbëdhjetë milione e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtëmijë e treqind e pesedhjete e shtate lekë).

2.2. Blerësi do te paguaje Çmimin e Shitjes si vijon:

2.2.1. Shuma prej LEK 91.857.813,6 (nëntëdhjetë e një milion e tetëqind e pesëdhjetë e shtate mije e tetëqind e trembëdhjetë presje gjashte lekë), qe përfaqëson edhe

A2021053950294039062

shumen e mbetur te detyrimit te kredisë se Shitësit ndaj Bankës CREDINS, detyrim për te cilin pasuria është barrësuar me hipotekë ne favor te Bankës CREDINS, do te paguhet nga Bleresi në llogarinë e kredisë së Shitësit pranë Bankës CREDINS nëpërmjet kësteve të barabarta mujore prej LEK 1.338.766,71 (një milion e treqind e tridhjete e tete mije e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashte presje shtatëdhjetë e një lekë), duke filluar prej këstit te kredisë të muajit nëntor 2021 dhe brenda datës 10 (dhjetë) të çdo muaji pasues.

2.2.2. Shuma prej LEK 26.142.186,4 (njëzet e gjashte milionë e njëqind e dyzet e dy mije e njëqind e tetëdhjetë e gjashte presje katër lekë) do te paguhet nga Blerësi ne llogarinë bankare te Shitësit pranë Bankës CREDINS me nr. IBAN AL53 2121 1360 0000 0000 0130 1785 ne monedhën LEK, brenda 36 (tridhjete e gjashte) muajve nga data e lidhjes së Kontratës.

2.3. Pas pagimit te 36 (tridhjete e gjashte) kësteve të para mujore te kredisë sipas nenit 2.2.1. dhe pas pagimit te shumes se plote prej LEK 26.142.186,4 (njëzet e gjashte milionë e njëqind e dyzet e dy mije e njëqind e tetëdhjetë e gjashte presje katër lekë) sipas nenit 2.2.2. dhe pas pagimit te shumes prej LEK 12.248.629 (dymbëdhjetë milionë e dyqind e dyzet e tete mije e gjashtëqind e njëzet e nëntë lekë) sipas nenit 2.4., Shitësi do te lëshojë deklaratën përkatëse noteriale për te kërkuar regjistrimin e kalimit të pronësisë mbi Pasurinë nga Shitësi te Blerësi pranë ASHK Tirane Rurale 1, duke mbetur Pasuria e barrësuar me hipoteke vetëm ne favor te Bankës CREDINS.

2.4. Blerësi njeh dhe pranon se vlera e investimit te kryer nga Shitësi ne Pasurinë e sipërpërmendur (pajisje, sende te luajtshme etj.) është ne vlerën prej LEK 12.248.629 (dymbëdhjetë milionë e dyqind e dyzet e tete mije e gjashtëqind e njëzet e nëntë lekë) dhe kundrejt kalimit te pronësisë mbi investimin e sipërpërmendur (pajisje, sende te luajtshme etj. qe gjenden ne Pasurinë objekt kontrate), Blerësi do t`i paguaje Shitësit brenda 36 (tridhjete e gjashte) muajve nga lidhja e kësaj Kontrate, edhe vlerën e dakordësuara te investimit ne shumen prej LEK 12.248.629 (dymbëdhjetë milionë e dyqind e dyzet e tete mije e gjashtëqind e njëzet e nëntë lekë) ne llogarinë bankare te Shitësit pranë Bankës CREDINS me nr. IBAN AL53 2121 1360 0000 0000 0130 1785. Shitblerja e investimit sipas përcaktimeve te kësaj pike është e lidhur ngushtësisht me shitblerjen e Pasurisë.

2.5. Blerësi merr përsipër, angazhohet e detyrohet te likuidoje shumen e taksës vendore mbi kalimin e pasurisë se paluajtshme ne momentin e paraqitjes se kërkesës për regjistrimin e kalimit te pronësisë mbi Pasurinë sipas përcaktimeve te nenit 2.3. me sipër pranë ASHK Tirana Rurale 1.

2.6. Palët bien dakord që shpenzimet noteriale si dhe tarifat e shërbimeve pranë ASHK Tiranë do të përballohen tërësisht nga Blerësi.

**Neni 3**
**Kalimi i titullit të pronësisë dhe posedimit**

A2021053950294039062

3.1. Kalimi i titullit te pronësisë mbi Pasurinë nga Shitësi te Blerësi dhe regjistrimi i titullit te pronësisë ne emër te Blerësit ne Regjistrin e Pasurive te Paluajtshme do te realizohet me lidhjen e kësaj Kontrate dhe pas pagimit te 36 (tridhjete e gjashte) késteve të para mujore te kredisë sipas nenit 2.2.1. dhe pas pagimit te shumes se plote prej LEK 26.142.186,4 (njëzet e gjashte milionë e njëqind e dyzet e dy mije e njëqind e tetëdhjetë e gjashte presje katër lekë) sipas nenit 2.2.2. dhe pas pagimit te shumes se plote prej LEK 12.248.629 (dymbëdhjetë milionë e dyqind e dyzet e tete mije e gjashtëqind e njëzet e nëntë lekë) sipas nenit 2.4.

3.2. Me lidhjen e kontratës dhe deri ne momentin e kalimit te titullit te pronësisë sipas nenit 3.1., Kontrata do te regjistrohet ne ASHK Tirana Rurale 1, duke u inskriptuar Pasuria edhe ne favor te Blerësit.

3.3. Noteri autorizohet shprehimisht nga Palët te depozitoje për regjistrim pranë ASHK Tiranë këtë Kontrate dhe çdo akt apo vërtetim te nevojshëm për përmbushjen e kushteve te saj me qellim kryerjen e regjistrimeve përkatëse.

3.4. Posedimi i Pasurisë do te kaloje nga Shitësi te Blerësi me lidhjen e kësaj Kontrate.

**Neni 4**
**Deklarime dhe garanci**

4.1. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se:
- (i) Shitësi është i vetmi pronar i ligjshëm i Pasurisë se identifikuar ne piken A, me sipër dhe ka te drejte te lidhe këtë Kontrate e te përmbushë te gjitha detyrimet qe rrjedhin prej saj;
- (ii) Shitësi nuk është pale ne ndonjë konflikt gjyqësor apo administrativ ne proces dhe/ose nuk kërcënohet nga fillimi i ndonjë procedure gjyqësore apo administrative kundër tij qe mund te cenoje Pasurinë;
- (iii) Pasuria është e lire nga çdo hipoteke, barre, kufizim apo e drejte reale apo garancie e te tretëve mbi te, veç barrës hipotekore ne favor te Bankës CREDINS, e përshkruar ne hyrje;
- (iv) Kjo Kontrate përbën detyrim ligjor, te vlefshëm dhe te ekzekutueshëm për Shitësin dhe sukseduesit e tij;
- (v) Shitësi ka paguar te gjithë detyrimet tatimore ne lidhje me Pasurinë dhe ne datën e kësaj Kontrate e deri në datën e kalimit te posedimit mbi Pasurinë garanton se nuk do të ketë asnjë detyrim tatimor dhe/ose detyrime ndaj te tretëve ne lidhje me Pasurinë për shërbime apo furnizime te kryera.

4.2. Blerësi deklaron dhe garanton Shitësin se:
- (i) Kjo Kontrate përbën detyrim ligjor, te vlefshëm dhe te ekzekutueshëm për Blerësin dhe trashëgimtarët e tij dhe se Blerësi i ka te gjithë te drejtat te lidhe këtë Kontrate dhe te përmbushë detyrimet qe rrjedhin prej saj;
- (ii) Blerësi do te paguaje te gjithë Çmimin e Shitjes sipas parashikimeve te kësaj Kontrate;

A2021053950294039062

(iii) Blerësi dëshiron te fitoje pronësinë mbi Pasurinë duke njohur e pranuar ekzistencën e barrës hipotekore sipas përshkrimit ne kartelën e pasurisë dhe ne këtë Kontrate;

(iv) Blerësi merr përsipër dhe detyrohet te likuidoje shumen e taksës vendore mbi kalimin e pasurisë se paluajtshme sipas ligjit, duke shkarkuar shitësin tërësisht nga çdo detyrim për këtë;

(v) Blerësi do te përballojë shpenzimet noteriale për lidhjen e kësaj Kontrate, si dhe tarifat për veprimet lidhur me regjistrimin e kalimit te titullit te pronësisë mbi Pasurinë pranë ASHK.

4.3. Shitësi dhe Blerësi pranojnë se deklarimet dhe garancitë e mësipërme janë bere me qëllimin për te nxitur njeri-tjetrin për te lidhur këtë Kontrate dhe ata kane lidhur këtë Kontrate duke u bazuar ne dhe marre te mirëqena këto deklarime dhe garanci.

**Neni 5**
**Tërheqja dhe shpërblimi i dëmit - Ligji i zbatueshëm dhe juridiksioni**

5.1. Secila pale mund te tërhiqet nga kjo Kontrate brenda 3 (tre) muajve nga lidhja e saj dhe pa asnjë penalitet, pretendim apo kërkesë te palës tjetër, pavarësisht masës se ekzekutimit te Kontratës.

5.2. Nëse një Pale tërhiqet nga kjo Kontrate pas 3 (tre) muajve nga lidhja e kësaj Kontrate, pala qe është tërhequr nga Kontrata do te detyrohet t'i paguaje Palës tjetër një dëmshpërblim te barabarte me EUR 500.000 (pesëqind mije Euro).

5.3. Kjo Kontrate do te zbatohet dhe interpretohet ne përputhje me legjislacionin shqiptar. Çdo çështje qe nuk gjen rregullim ne këtë Kontrate do te rregullohet sipas dispozitave te Kodit Civil te Republikës se Shqipërisë.

5.4. Kompetente për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshjeje qe mund te linde midis Shitësit dhe Blerësit ne lidhje me këtë Kontrate dhe qe nuk mund te zgjidhet me mirëkuptim midis tyre, do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

**Neni 6**
**Anekset**

6.1. Kësaj kontrate i bashkëngjiten:
- 6.1.1. Certifikata për vërtetimin e pronësisë së shitësit mbi pasurinë;
- 6.1.2. Kartela e pasurisë;
- 6.1.3. Harta treguese e pasurisë;
- 6.1.4. Deklarata Noteriale me nr. 9606 rep, nr. 3134 kol, datë 12.11.2021 e noter Julian Zhelegu, lëshuar nga Banka CREDINS;
- 6.1.5. Ekstrakt i regjistrit tregtar te Shitësit;
- 6.1.6. Vendimi i ortakut te vetëm te Shitësit për miratimin e shitjes dhe autorizimin e lidhjes se kontratës;

A2021053950294039062

6.1.7. Vendimi i ortakut te vetëm te Blerësit për miratimin e shitjes dhe autorizimin e lidhjes se kontratës;
6.1.8. Dokument identifikimi i administratorit / përfaqësuesit ligjor të Shitësit dhe Blerësit.

Kontrata u redaktua nga unë noteri sipas kërkesës se palëve ne gjuhen shqipe ne 4 (katër) kopje origjinale, dhe pasi iu lexua dhe iu shpjegua palëve nga unë noteri me zë te larte dhe te qarte u kuptua dhe u pranua prej palëve, u nënshkrua rregullisht dhe pa vërejtje prej palëve ne praninë time dhe unë, noteri, e vërtetoj sipas ligjit dhe për te gjithë efektet e tij.

**SHITESI**
"FaH & Klo" shpk.
Përfaqësuar nga Administratori
Basri Hakcani

Basri Hakcani

NUIS: L91408031L
FaH & Klo
Sh.p.k.
Tirana - Albania

**BLERESI**
"K.D Company" shpk.
Përfaqësuar nga Administratori
Xhuljan Disha

Xhuljan Disha

NUIS M12204073B
K.D Company
Sh.p.k.
TIRANE - ALBANIA

**NOTERI**
Julian Zhelegu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

# ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI PRONËSIE

| PRONARI/BASHKËPRONARËT | | |
|---|---|---|
| Emri (Emër, Atësi dhe Mbiemër) | Nr. Personal Id | Pjesa(-/-) |
| FaH & Klo | L91408031L | 1/1 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Numri i Pasurisë | 125/159 | | |
| Kodi Unik | 3266016206 | | |
| Zona Kadastrale | 3266 | | |
| Lloji i Pasurisë | TRUALL | | |
| Sipërfaqja e pasurisë (m2) | Totali: 921 | Truall: 921 | Ndërtesë: 300 |
| Vlera Aktuale e Pasurisë | | | |
| Adresa e Pasurisë | TIRANE, SAUK, Rr.: - | | |

**DREJTORI**
Risena Xhaja

Risena Xhaja

Digitally signed by:
Risena Xhaja
Date: 2021.01.16
11:33:27 +02'00'

**Data e lëshimit** 16/01/2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS DREJTORIA VENDORE

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1
Date:2021/01/16 09:21:25 +02'00'
L91408031L20210116092118881L1014

ASHK
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)*

Miratuar me VKM 782, Datë 07.10.2020

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS**

## KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 3266016206
(Nga ____ , Në ____)

### A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 3266 , Lloji i Pasurisë: TRUALL , Nr. i Pasurisë: 125/159 , Sipërfaqja Totale 921 m2,
(Nga të Cilat Truall 921 m2; Ndërtesë 300 m2)

Indeksi i Hartës Kadastrale K-34-100-27-D , Numri i Pemëve: 0 ,
Adresa e Pasurisë: Bashkia SAUK , Rruga - , Ndërtesa Nr. __ , SH/K __ , Apartamenti Nr. __
Vlera e Pasurisë:
Fillestare __ Leke (Akti Nr. __ , Dt. ____), Rivlerësim 1 Leke (Akti Nr. 1, Dt. 15/01/2021)

### B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: FaH & Klo , Nr. Identifikimi/NIPT L91408031L , Pjesa Takuese 1/1
Adresa e Pronarit: Bashkia TIRANË , Rruga ____ , Ndërtesa Nr. __ , SH/K __ , Apartamenti Nr. __

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Regjistruar: Nr. 00011574 , Datë: 16/01/2021

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. ____ , me Kod Unik ____*

### B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Përshkrimi i Objektit të Aktit: ____
Regjistruar: Nr. __ , Datë: ____

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS**

## KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

### C-TË DREJTAT REALE

| Nr. Regjistrimi | Dt. Regjistrimi | Lloji i të Drejtës | Të Dhënat e Aktit | | | Afati i Vlefshmërisë | Përfitues | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Emërtim | Nr. | Datë | | Emër Atësi Mbiemër | Nr. Identifikimi/ NIPT |
| | | | | | | | | |

### D - KUFIZIMET E PRONËSISË

| Nr. Regjistrimi | Dt. Regjistrimi | Lloji i Kufizimit | Të Dhënat e Aktit | | | Afati i Kufizimit | Përfitues/Kërkues | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Emërtim | Nr. | Datë | | Emër Atësi Mbiemër | Nr. Identifikimi/ NIPT |
| 00011071 | 29/10/2020 | | PASURIA BLLOKOHET NE FAVOR TE BANKA CREDINS SH.A, PER SHUMEN 100.000.000 LEKE K.HIP NR 6681 REP NR 2510 KOL DT 29.10.2020 NOT J.ZHELEGU. | | | 0 | | |

### E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: ____, Emërtimi i Aktit: ____, Nr. __, Datë: ____
Regjistruar: Nr. __, Datë: ____
Përshkrimi: __

**DREJTORI**
**Risena Xhaja**

Risena Xhaja
Digitally signed by: Risena Xhaja
Date: 2021.01.16 11:33:06 +02'00'

**Data e lëshimit 16/01/2021**

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1
Date:2021/01/16 09:20:47 +02'00'
L91408031L2021011609204043ASHK

*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)*

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS**

## FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

| | |
|---|---|
| ZONA KADASTRALE: 3266 | KODI UNIK: 3266016206 |
| NUMRI PASURISË: 125/159 | INDEKSI HARTËS: K-34-100-(25-D) |

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

SH 1: 2500

L.G.

DREJTORI
Risena Xhaja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS TIRANË RURALE DREJTORIA VENDORE

Data e leshimit 15.01.2021




Risena Xhaja

Digitally signed by Risena Xhaja
Date: 2021.01.16
11:33:52 +02'00'

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER JULIAN ZHELEGU
ADRESA Njesia Bashkiake nr. 5, Rr. Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr. 2
TEL: 0682027818

# DEKLARATË NOTERIALE

(PËR FSHIRJE HIPOTEKE)

**Nr. repertori: 9606** **Nr. koleksioni: 3134**

**Tirane më 12/11/2021**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë

A2021053950341420977

PULLE TARIFE

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA E NOTERISË** Tiranë
**Nr.** 3606 **Rep.**
**Nr.** 3134 **Kol.**

## DEKLARATË NOTERIALE

Sot më datë 12/11/2021, para meje [illegible], noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqitën personalisht:

**Znj. Lorna Dedja,** lindur më 02.07.1987, me Letërnjoftim Nr. 035415675, me cilësinë Drejtore Dege, pranë "BANKA CREDINS" SH.A, Tiranë, regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin Nr. 28969, datë 31.01.2003, rregjistruar në organin tatimor me Kodin Fiskal Nr.3709529, NIPT Nr. K31608801O, si dhe me Licensën e Bankës së Shqipërisë Nr.16, datë 31.03.2003;--------------------------------------------------------------------------------;

**Z. Enian Zeka,** lindur me 08.02.1988, me Leternjoftim Nr. 034049901, me cilesinë Analist Kredie prane "BANKA CREDINS" SH.A, Tirane, regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin Nr. 28969, datë 31.01.2003, regjistruar në organin tatimor me Kodin Fiskal Nr.3709529, NIPT Nr. K31608801O, si dhe me Licensën e Bankës së Shqipërisë Nr.16, datë 31.03.2003--------------------------------------------------------------------------------;

Të dy personat e mësiperm madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, të cilët deklaruan si më poshtë;

1- "Ne, të sipër nënshkruarit, në cilësinë e përfaqësuesve ligjorë të "BANKA CREDINS" SH.A me anën e këtsaj deklarate noteriale, japim pëlqimin per lejim regjistrimi kontrate shitje me rezerve qe do te nenshkruhet midis shoqerise FaH & Klo Shpk me NUIS L91408031L ne cilesine e shitesit dhe shoqerise K.D Company Shpk me NUIS M12204073B ne cilesine e bleresit per pasurine objekt shitblerje si me poshte shenuar, e bllokuar ne favor te Banka Credins Sha si me poshte shenuar ***me kusht qe edhe pas regjistrimit te kontrates se shitjes me rezerve pasuria objekt shitblerje te vazhdoje të qëndroje e bllokuar duke ruajtur dhe mbartur bllokimin/inskriptin e radhes se pare që aktualisht rëndon mbi te në favor të shoqerisë "Banka Credins" Sh.a;***

- Pasuria e regjistruar ne Agjencine Shteterore te Kadastres, Drejtoria Vendore Tirane Rurale 1, e ndodhur ne zonen kadastrale Nr. 3266, me Nr. Pasurie 125/159, me kod unik 3266016206 e llojit "truall", me siperfaqe totale 921 m/2, nga te cilat 921 m/2 truall dhe 300 m/2 me adrese: Sauk , Tirane ne pronesi te FaH & Klo.

- **Inskript Nr.11071, Dt. 29.10/2020 ne favor te "Banka Credins" Sh.A regjistruar sipas Kontrates se Hipotekes Nr. 6681 Rep., Nr. 2510 Kol., date 29.10.2020.**

Pasuria do te vazhdoje te qendroje e bllokuar ne radhe te pare ne favor te banka Credins sha edhe pas regjistrimit te kontrates se shitjes me rezerve qe do te nenshkruhet midis shoqerise FaH & Klo Shpk me NUIS L91408031L ne cilesine e shitesit dhe shoqerise K.D Company Shpk me NUIS M12204073B ne cilesine e bleresit ne kartelen e pasurise se paluajtshme me numer pasurie 125/159.

Bazuar ne nenin 25 te ligjit Nr.111/2018 Dt. 02.07.2019 "Per Kadastren", kjo deklarate duhet te regjistrohet ne Agjencine Shteterore te Kadastres nga mbajtesi i titullit të pronesise brenda 30 diteve nga data e hyrjes ne fuqi te deklarates. Nese regjistrohet pertej afatit 30 ditor, kerkuesi i regjistrimit përveç tarifes së regjistrimit, për çdo ditë vonese, duhet të paguaje edhe kamatëvonese, të barabartë me 10 % e tarifës së regjistrimit, por jo më shumë se 300 000 lekë.

Sa më sipër, deklarojmë nën përgjegjësinë tonë personale.--------------------------------------;

Unë, noteri, pasi dëgjova deklarimet e bëra nga deklaruesit dhe verifikova dokumentet përkatëse, konstatova se deklarata është në përputhje me vullnetin e lirë dhe të pavarur të deklaruesve dhe konform ligjit. Për këtë arsye, unë e nënshkruaj atë duke i dhënë forcën e nevojshme ligjore.-----------------------------------------------------------------------------------------;

**DEKLARUES**
**"BANKA CREDINS" SH.A.**

**Lorna Dedja**
**Drejtore Dega Tirana Qender**

Lorna Dedja

**NOTER**
JULIAN ZHELEGU

**Enian Zeka**
**Analist Kredie**

ENIAN ZEKA

CREDINS bank

# TË DHËNAT E LLOGARISË
## ACCOUNT DETAILS

| | |
|---|---|
| Banka / The Bank | CREDINS BANK sh.a., RRUGA 'VASO PASHA', Nr. 8, TIRANË |
| Kodi SWIFT / SWIFT Code | CDISALTRXXX |
| Titullari i Llogarisë / Account Holder | K.D COMPANY SH.P.K |
| Nr.Personal \| NIPT / SSN \| Tax ID | M12204073B |
| Adresa e Klientit / Customer Address | LAGJJA SAUK I VJETER RR XHABRAHIMET ND NR 21, TIRANE |
| Numri i Llogarisë / Account Number | 00001594014 |
| Monedha / Currency | ALL |
| Data e Çeljes / Account Start Date | 08.10.2021 |
| IBAN* | AL89 2121 1009 0000 0000 0159 4014 |

08.10.2021

INS bank

# TË DHËNAT E LLOGARISË
## ACCOUNT DETAILS

| | |
|---|---|
| Banka / The Bank | CREDINS BANK sh.a., RRUGA 'VASO PASHA', Nr. 8, TIRANË |
| Kodi SWIFT / SWIFT Code | CDISALTRXXX |
| Titullari i Llogarisë / Account Holder | FAH&KLO SH.P.K. |
| Nr.Personal \| NIPT / SSN \| Tax ID | L91408031L |
| Adresa e Klientit / Customer Address | RRUGA XHA BRAHIMET LAGJIA SAUK ND 21, TIRANE |
| Numri i Llogarisë / Account Number | 00001301785 |
| Monedha / Currency | ALL |
| Data e Çeljes / Account Start Date | 25.11.2019 |
| IBAN* | AL53 2121 1360 0000 0000 0130 1785 |

CREDINS bank
Dega Tirana
25.11.2019

REPUBLIKA E SHQIPERISE.
SHOQERIA FaH & Klo shpk.
TIRANE

NIPT- L91408031L

**VENDIM**

date 01.10.2021.
I ORTAKUT TE VETEM THEMELUS.

Une Basri Hakcani, me cilesine e ortakut te vetem themelues i shoqerise "FaH & Klo" shpk , mbeshtetur ne ligjin Nr.9901 date 14.04.2008,"Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" neni 81 , dhe statutit te shoqerise ;

VENDOSA:

1. Te filloje procedura per shitje te aseteve, te shoqerise ;
   Me nr. pasurie 125/159, vol 16,f.206, Truall me siperfaqe 921 m2 ,dhe ndertese 300 m2 godine me 3 kate me siperfaqe totale 1245.8 m2, Sauk Tirane dhe nr.pasurie 1255/159/1 ne te njejten siperfaqe trualli me siperfaqe ndertimi 337.3 m2, 1 kat shtese, Sauk Tirane.

Vlera e aseteve te mesiperme ,sipas kontabilitetit eshte :
- Vlera fillestare eshte 115,990,551 leke .
- Amortizimi i nderteses 3,866,352 leke
- Vlera e mbetur , eshte 112,124,199 leke .

Vlera qe duhet te shitet objekti bashke me truallin do te jete jo me pak se 117,730,000 leke.
Shitja do jete e perjashtuar nga TVSH , mbeshtetur ne Ligjin 92/2014 Per Tatimin Mbi Vleren e Shtuar. Neni 53, pika g.
g) furnizimi i ndërtesave apo i pjesëve të një ndërtese, si edhe furnizimi i tokës, në të cilën qëndron ndërtesa, përveç furnizimit të procesit të ndërtimit;

2. Ngarkohet administrator i shoqerise per ndjekjen e proçedurava Ligjore..

3. Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

4. Vendimi te depozitohet ne QKR.

Ortak i vetem themelues

Basri Hakcani

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

OKB
Qendra Kombëtare e Biznesit
National Business Center

# EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | | |
|---|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | L91408031L | |
| 2. Data e Regjistrimit | 08/02/2019 | |
| 3. Emri i Subjektit | FaH & Klo | |
| 4. Forma ligjore | SHPK | |
| 5. Data e themelimit | 07/02/2019 | |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 07/02/2019 | |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Tirane Tirane TIRANE Rruga "Ded Gjo Luli", me pasuri e paluajtëshme Nr.6/901, zona kadastrale 8350, vol.38, faqe 211 | |
| 8. Kapitali | 1.000,00 | |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 1,00 | |
| 9. Objekti i aktivitetit | Import dhe eksport, tregetim me pakice dhe shumice te produkteve ushqimore te ndryshme, biletari te ndryshme. Sherbim ne menaxhimin e transportit urban publik qytetas. Hoteleri dhe ushtrim aktiviteti ne fushen e rezidencave dhe konvikteve studentore. Bar-kafe, restorant, club. Studio muzikore, (organizim, menaxhim eventesh,prodhim muzikor,menaxhim artistesh). Menza studentore dhe shërbime lavanterie për llogari të vet.Punime sherbimi. Punime per rikualifikimin dhe mirembajtje ne siperfaqe te gjelberta parqe-pyll parqe, pastrim i siperfaqeve urbane. Furnizim-vendosje, mirembajtje dhe riparime per elemente dekorative stola, kosha rrugore, lulishte, parqe-pyll parqe. Grumbullim dhe transportim te mbetjeve te ngurta jo te rrezikshme. Tregtim i pajisjeve per mbrojtje personash per qellime higjeno-sanitare dhe spitalore. Sherbime nderhyrese higjeno-shendetesore (Dezifektim, Dezinsektim, Deratizim). Vendi i kryerjes se veprimtarise do te zhvillohet ne te gjithe Republiken e Shqiperise. Shërbime lavanterie për të tretë. Ndertime hidraulike e hidroteknike, ndertime ujsjelles, kanalizime, kanale e impiante vaditje,ndertime impianti te sistemit te ujit. | |
| 10. Administratori/ët | Basri Hakcani | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 06/10/2021 | Deri: 06/10/2026 |

Kopje nga web

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

OKB
Qendra Kombëtare e Biznesit
National Business Center

| | | |
|---|---|---|
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 12. Eksperti/ët Kontabël (nëse ka) | Eglina Pjetërnikaj | |
| 12.1 Afati i emërimit | Nga: 23/12/2019 | Deri: |
| 13. Ortakët | BasriHakcani | |
| 13.1 Vlera e kapitalit | Para: 1.000,00 | Natyre: |
| 13.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 100,00 | |
| *- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)* | | |
| 14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | Tirane Tirane TIRANE Olivar Hotel Tirana, Zona Kadastrale nr.3266,Tirane Tirane Tirane TIRANE Autoveture Renault AA 333 FB. | |
| 15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: FaH & Klo<br>E-Mail: xhaniflutura@gmail.com<br>Telefon: 0692626109 | |
| 16. Statusi: | Aktiv | |

Datë: 25/11/2021

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga web

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

QKB
Qendra Kombëtare e Biznesit
National Business Center

# EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | | |
|---|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | M12204073B | |
| 2. Data e Regjistrimit | 04/10/2021 | |
| 3. Emri i Subjektit | K.D Company | |
| 4. Forma ligjore | SHPK | |
| 5. Data e themelimit | 29/09/2021 | |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 29/09/2021 | |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Tirane Tirane TIRANE Lagjja "Sauk Vjeter",Rruga "Xhabrahimet", Ndertesa Nr.21. | |
| 8. Kapitali | 1.000,00 | |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 1,00 | |
| 9. Objekti i aktivitetit | Import dhe eksport, tregetim me pakice dhe shumice te produkteve ushqimore te ndryshme, biletari te ndryshme. Sherbim ne menaxhimin e transportit urban publik qytetas. Hoteleri dhe ushtrim aktiviteti ne fushen e rezidencave dhe konvikteve studentore. Bar-kafe, restorant, club. Menza studentore dhe sherbime lavanterie per llogari te vet. Punime sherbimi. Punime per rikualifikimin dhe mirembajtje ne siperfaqe te gjelberta parqe-pyll parqe, pastrim i siperfaqeve urbane. Furnizim-vendosje, mirembajtje dhe riparime per elemente dekorative stola, kosha rrugore, lulishte, parqe-pyll parqe. Grumbullim dhe transportim te mbetjeve te ngurta jo te rrezikshme. Tregetim i pajisjesh per mbrojtje personash per qellime higjeno-sanitare dhe spitalore. Sherbime nderhyrese higjeno-shendetesore (Dezifektim, Dezinsektim, Deratizim). Vendi i kryerjes se veprimtarise do te zhvillohet ne te gjithe Republiken e Shqiperise. Sherbime lavanterie per te trete. | |
| 10. Administratori/ët | Xhuljan Disha | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 29/09/2021 | Deri: 29/09/2026 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 12. Ortakët | HamideGjeçi | |

Kopje nga web

**VENDIM**
**I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE "FaH & Klo" shpk.**

Sot, me 25 / 11 / 2021, ne seline e shoqerise "FaH & Klo" shpk, ortaku i vetem i shoqerise "FaH & Klo" shpk, një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar e që funksionon sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar me NUIS L91408031L dhe me seli në adresën rruga "Ded Gjo Luli", me pasuri e paluajtshme Nr.6/901, zona kadastrale 8350, vol. 38, faqe 211, Tiranë, ne përputhje me dispozitat ligjore dhe statutore,

**V E N D O S I:**

1- Miratimin e Shitjes se pasurisë se paluajtshme TRUALL me sipërfaqe prej 921 (nëntëqind e njëzet e një) metra katrorë, nga e cila NDERTESE 3 (tre) katëshe "Godine banimi 3 kate me podrum", e ndërtuar sipas lejes se ndërtimit me nr. 5, date 29.9.2011, me sipërfaqe totale 1245,8 metra katrore, dhe kati i katërt (me destinacion social-ekonomik) dhe sipërfaqe 337,3 metra katrore, i fituar sipas lejes se legalizimit, bashkëlidhur, që ndodhet në Sauk, Tirane, dhe është regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme pranë ASHK Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1 me nr. pasurie 125/159, ZK 3266, vol. 16, f. 206, kod unik pasurie 3266016206. Çmimi i shitjes se pasurise se mësipërme te jete LEK 118.000.000 (njëqind e tetembedhjete milione leke).

2- Miratimin e shitjes se pajisjeve dhe sendeve te luajtshme gjendje ne pasurinë e sipërpërmendur kundrejt vlerës se investimit prej LEK 12.248.629 (dymbëdhjetë milionë e dyqind e dyzet e tete mije e gjashtëqind e njëzet e nëntë lekë).

3- Autorizimin e administratorit te shoqërisë, Basri Hakcani, per lidhjen e kontratës/ave perkatese te shitjes me blerësin "K.D Company" shpk, te përfaqësuar po nga Basri Hakcani, me kompetença te plota e te pakufizuara, duke qene i autorizuar tërësisht te vendose mbi te gjithë termat dhe kushtet e tjera te shitjes pa kufizim si dhe per nenshkrimin e akteve perkatese qe do te konsiderohen te nevojshme e qe do te jene ne funksion te shitjes, duke perfaqesuar shoqerine para cdo zyre noteriale, banke etj., ne lidhje me realizimin e shitjes se pasurive te sipershenuara, e duke ndermarre cdo veprim tjeter te domosdoshem qe nuk eshte shprehur ne kete vendim por qe eshte ne funksion te kesaj shitjeje nga ana e shoqerise.

**ORTAKU I VETEM**

BASRI HAKCANI

NUIS L91408031L
FaH & Klo
Sh.p.k.
Tirane - Albania

**VENDIM**
**I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE "K.D Company" shpk.**

Sot, me 25 / 11 / 2021, ne seline e shoqerise "K.D Company" shpk, ortaku i vetem i shoqerise "K.D Company" shpk, një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar e që funksionon sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar me NUIS M12204073B dhe me seli në adresën Lagjja Sauk i Vjetër, rruga "Xhabrahimet", ndërtesa nr. 21, Tiranë, ne përputhje me dispozitat ligjore dhe statutore,

**VENDOSI:**

1- Miratimin e blerjes se pasurisë se paluajtshme TRUALL me sipërfaqe prej 921 (nëntëqind e njëzet e një) metra katrorë, nga e cila NDERTESE 3 (tre) katëshe "Godine banimi 3 kate me podrum", e ndërtuar sipas lejes se ndërtimit me nr. 5, date 29.9.2011, me sipërfaqe totale 1245,8 metra katrore, dhe kati i katërt (me destinacion social-ekonomik) dhe sipërfaqe 337,3 metra katrore, i fituar sipas lejes se legalizimit, bashkëlidhur, që ndodhet në Sauk, Tirane, dhe është regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme pranë ASHK Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1 me nr. pasurie 125/159, ZK 3266, vol. 16, f. 206, kod unik pasurie 3266016206. Çmimi i blerjes se pasurise se mësipërme te jete LEK 118.000.000 (njëqind e tetembedhjete milione leke).
2- Miratimin e blerjes se pajisjeve dhe sendeve te luajtshme gjendje ne pasurinë e sipërpërmendur kundrejt vlerës se investimit prej LEK 12.248.629 (dymbëdhjetë milionë e dyqind e dyzet e tete mije e gjashtëqind e njëzet e nëntë lekë).
3- Autorizimin e administratorit te shoqërisë, Xhuljan Disha, per lidhjen e kontratës/ave perkatese te blerjes me shitësin "FaH & Klo" shpk te përfaqësuar po nga Xhuljan Disha, me kompetenca te plota e te pakufizuara, duke qene i autorizuar tërësisht te vendose mbi te gjithë termat dhe kushtet e tjera te blerjes pa kufizim si dhe per nenshkrimin e akteve perkatese qe do te konsiderohen te nevojshme e qe do te jene ne funksion te blerjes, duke perfaqesuar shoqerine para cdo zyre noteriale, banke etj., ne lidhje me realizimin e blerjes se pasurive te sipershenuara, e duke ndermarre cdo veprim tjeter te domosdoshem qe nuk eshte shprehur ne kete vendim por qe eshte ne funksion te kesaj blerjeje nga ana e shoqerise.

**ORTAKU I VETEM**

Hasmeda Gjoçi

NUIS M12204073B
K.D Company
sh.p.k.
TIRANË - ALBANIA

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**

**DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER JULIAN ZHELEGU**
**ADRESA Njesia Bashkiake nr. 5, Rr. Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr. 2**
**TEL: 0682027818**

# DEKLARATË NOTERIALE

(DEKLARATË ME PËRMBAJTJE TË TJERA)

**Nr. repertori: 10053** **Nr. koleksioni: 3315**

**Tirane më 25/11/2021**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

A2021053950351896145

ZYRA E PULLIT
PAGUAR

A2021053950351896145

## DEKLARATË NOTERIALE

Sot, më datë 25 Nentor 2021 (dymije e njezete e nje), perpara meje Noter JULIAN ZHELEGU, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Njesia Bashkiake nr. 5, Rr. Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr. 2, u paraqit personalisht:

**DEKLARUESE:**
**Erinda Hakcani**, atësia Festim, amësia Verije, shtetase Shqiptare, lindur në Poliçan, Skrapar dhe banuese në TIRANË, me adresë Gaspër Guga; Nd. 28; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 13/11/1987, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 032477610 dhe nr. personal I76113039E;

E cila nën përgjegjësinë e saj personale dhe në vullnet të lirë e të plotë, në bazë të nenit 79 të Kodit Civil Shqiptar, nenit 62, 63 , të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", më deklaroi si më poshtë vijon:

*"Une e nenshkruara Erinda Hakcani, ne cilesine e bashkeshortes se z. Basri Hakcani, deklaroj se jam ne dijeni dhe miratoj teresisht shitjen e pasurise TRUALL me sipërfaqe prej 921 (nëntëqind e njëzet e një) metra katrorë, nga e cila NDERTESE 3 (tre) katëshe "Godine banimi 3 kate me podrum", e ndërtuar sipas lejes se ndërtimit me nr. 5, date 29.9.2011, me sipërfaqe totale 1245,8 metra katrore, dhe kati i katërt (me destinacion social-ekonomik) dhe sipërfaqe 337,3 metra katrore, i fituar sipas lejes se legalizimit, bashkëlidhur, që ndodhet në Sauk, Tirane, dhe është regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme pranë ASHK Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1 me nr. pasurie 125/159, ZK 3266, vol. 16, f. 206, kod unik pasurie 3266016206, ne favor te blerësit **"K.D Company" shpk**, një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar e që funksionon sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar me NUIS M12204073B dhe me seli në adresën Lagjja Sauk i Vjetër, rruga "Xhabrahimet", ndërtesa nr. 21, Tiranë, e përfaqësuar ligjërisht nga Administratori i saj i vetëm **Xhuljan Disha**.*
*Gjithashtu miratoj veprimet e bashkeshortit tim Basri Hakcani pa asnje kufizim.*
*Per sa me siper e leshoj kete deklarate per te vertetuar vullnetin tim per shitjen e pasurise si me siper, dhe per te konfirmuar gjithashtu se bashkeshorti im ka tagra te plota per shitjen dhe transferimin e pronesise sipas kushteve dhe afateve qe do te caktoje vete pa asnje kufizim.*
*Sa me siper e deklaroj nen pergjegjesine time te plote dhe ne njohje te pasojave ligjore te nje deklarimi te rreme, duke miratuar qe tani veprimet qe z. Basri Hakcani do te kryeje pa kufizime."*

Deklarata e mësipërme, u hartua në gjuhën shqipe dhe u lexua nga unë Noteri me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të deklaruese të mësipërme. Pasi ajo deklaroi se u njoh dhe i kuptoi efektet juridike të aktit, e nënshkruan atë rregullisht përpara meje Noterit.

Unë Noteri, verifikova identitetin e saj nëpërmjet dokumentit të identitetit cituar më sipër dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin nenit 62, pika 1, germa "ll", të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e deklaruesit/ses. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të kësaj deklarate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**DEKLARUESE**
Erinda Hakcani

Erinda Hakcani

**NOTER**
JULIAN ZHELEGU

## ANEKS
## Llogarite bankare ndërmjetëse OSS te Noterit Julian Zhelegu

| Nr. | Banka | Monedha | Llogaria | Swift code |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **CREDINS BANK** | EUR | AL68212110160000000000406290 | |
| 2 | CREDINS BANK | LEK | AL79212110160000000000406286 | |
| 3 | CREDINS BANK | GBP | AL16212110160000000000801337 | |
| 4 | CREDINS BANK | USD | AL34212110090000000000942970 | |
| 5 | **ALPHA BANK** | EUR | AL52902112090201230017192198 | |
| 6 | ALPHA BANK | LEK | AL93902112090201230019310037 | |
| 7 | ALPHA BANK | USD | AL79902112090201230027930873 | |
| 8 | **ABI BANK** | EUR | AL92210110290000000001528317 | |
| 9 | ABI BANK | LEK | AL22210110290000000001413177 | |
| 10 | ABI BANK | USD | AL93210110290000000002603156 | |
| 11 | **RAIFFEISEN BANK** | EUR | AL91202111300000000050506899 | |
| 12 | RAIFFEISEN BANK | LEK | AL09202111300000000040506899 | |
| 13 | **FiBANK** | EUR | 1000006052100 | |
| 14 | FiBANK | LEK | 1321511031 | |
| 15 | **INTESA SANPAOLO BANK** | UDS | AL35208110080000020382835903 | |
| | **INTESA SANPAOLO BANK** | EUR | AL62208110080000020382835902 | |
| 16 | INTESA SANPAOLO BANK | LEK | AL89208110080000020382835901 | |
| 17 | **PROCREDIT BANK** | EUR | AL45209111080000109648320102 | |
| 18 | PROCREDIT BANK | LEK | AL56209111080000109648320001 | |
| 19 | **TIRANA BANK** | EUR | AL63206110110000110308325100 | |
| 20 | TIRANA BANK | LEK | AL79206110040000100308325101 | |
| 21 | **OTP BANK** | EUR | AL74213110990000000001243721 | |
| 22 | OTP BANK | LEK | AL76213110130000000001581145 | |
| 23 | OTP BANK | USD | AL37213110990000000001498624 | |
| 24 | **BKT** | LEK | AL21205117155654 86CLPRBLALLB | NCBAALTX |
| 25 | BKT | EUR | AL69205115715654 86CLPRBFEURA | |